

LIGJ
Nr.7666, datë 26.1.1993

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR RIVLERËSIMIN E LEJEVE
PËR USHTRIMIN E AVOKATISË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7541, DATË
18.12.1991 "PËR AVOKATINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Ministrinë e Drejtësisë krijohet komisioni për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë të lëshuara deri në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ministri i Drejtësisë kryeson komisionin. Ai propozon përbërjen e komisionit, i cili miratohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 2

Në ligjin nr.7541, datë 18.12.1991 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

Leja për ushtrimin e profesionit si avokat jepet nga Këshilli Mbikëqyrës për shtetasit shqiptarë që kanë mbaruar arsimin e lartë juridik dhe nuk janë dënuar për vepra penale të rënda, si dhe plotësojnë kriteret morale e profesionale.

Profesionin e avokatisë e ushtrojnë edhe pedagogët e Fakultetit të Drejtësisë.

Neni 3

Shtohet neni 12-a me këtë përmbajtje:

Nuk lejohet të punojnë si avokatë:

- a) Ish-oficerët e Sigurimit të Shtetit dhe bashkëpunëtorët e tij.
- b) Ish-anëtarët e Komiteteve të PPSH si dhe punonjësit e aparateve të tyre në qendër, rrethe e rajone. Ish drejtuesit e organeve shtetërore në qendër e rrethe (ministra, zv.ministra, drejtorë drejtorie si dhe kryetarë, zv.kryetarë e sekretarë të komiteteve ekzekutive në rrethe e rajone).
- c) Ish punonjësit e burgjeve dhe kampeve të vuajtjes së dënimit.
- d) Ata që kanë mbaruar Fakultetin e Drejtësisë mbi bazën e arsimit të shkollës së lartë të partisë si dhe ish kryetarët e zyrave të kuadrit të gjithë niveleve.
- e) Ata që kanë marrë pjesë si hetues, prokurorë ose gjyqtarë në proceset politike speciale, të montuara, si dhe ata që kanë kryer funksione të larta drejtuese në organet qendrore të drejtësisë.
- f) Ata që kanë përdorur dhunën fizike ose psikike gjatë hetimeve apo veprimeve të tjera, si dhe ata që kanë marrë pjesë në vrasjet në kufi.

Neni 4

Ankimi kundër vendimit të marrë sipas nenit 12-a të këtij ligji, bëhet nga personi i interesuar brenda 30 ditëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili duhet ta shqyrtojë e t'i përgjigjet ankesës brenda 2 muajve nga data e dorëzimit.

Neni 5

Koha e ndalimit të ushtrimit të profesionit të avokatisë për personat që preken nga ky ligj është 5 vjet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.445, datë 2.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha